



# PASQYRË PËR VITIN 2018

## HISTORIA JONË

Në vitin 1961 kryetari i Shteteve të Bashkuara të Amerikës Xhon F. Kenedi e themeloi Korpusin e Paqes me qëllim të promovojë paqe dhe miqësi në botë dhe t'i stimulojë amerikanët të jetojnë dhe punojnë në shtete në zhvillim të sipër. Misioni dhe tre qëllimet tona mbeten njëjtë të rëndësishme edhe sot ashtu siç ishin edhe gjatë formimit të Korpusit të Paqes.

„...Për të gjithë amerikanët e rinj të cilët do të jetojnë në shtet të huaj, ta dijnë që kanë një detyrë shumë të rëndësishme – t'ju mundësojnë njerëzve një jetë të mirë, gjë që është parakusht për liri dhe paqe“ – Xhon F. Kenedi

## QËLLIMET TONA

1. Të mundësohen vullnetarë që do të japin kontributin e tyre për zhvillimin e vendeve të interesuara;
2. Promovimi i një imazhi më të mirë të amerikanëve te popujt të cilëve iu shërbehet;
3. Promovimi i një imazhi më të mirë të popujve të tjerë te amerikanët.

## KORPUSI I PAQES NË MAQEDONI

Maqedonia gjithmonë ka qenë një ndër shtetet e para e përzgjedhur për shërbim vullnetar. Programi i Korpusit të Paqes në Maqedoni u themelua në vitin 1996 me ftesë të Republikës së Maqedonisë. Që atëherë, 735 vullnetarë kanë qenë të angazhuar nëpër shkolla, komuna, organizata joqeveritare dhe institucione tjera publike për t'i plotësuar kërkesat e komuniteteve në vend. Si mirënjohje për rëndësinë e punës së tyre dhe dedikimit të vullnetarëve tanë, në vitin 2014, kryetari i Republikës së Maqedonisë i dhuroi Korpusit të Paqes Dekoraten për të arriturat në Maqedoni. Në vitin 2017 Korpusi i Paqes pati Memorandum bashkëpunimi me Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës, Ministrinë e Vetëqeverisjes Lokale, Ministrinë për Punë dhe Politikë Sociale, Agjencionin për Rini dhe Sport, si edhe me një rrjetë të gjerë të organizatave joqeveritare.

## VITI 2018 NË NUMRA

- 4 Gjuhë lokale të mësuara nga vullnetarët
- 23 Vjet në Maqedoni
- 51 Shkolla fillore me vullnetarë në vitin 2018
- 87 Vullnetarë në shërbim në vitin 2018
- 134 Mësimdhënës lokalë - partnerë në vitin 2018
- 126 Organizata joqeveritare - partnerë në vitin 2018
- 383 Përfitues nga programi për nevoja të veçanta
- 10881 Nxënës të mësuar nga vullnetarë në vitin 2018

7.635 persona, shumica të rinj, përfituan nga pjesëmarrja në aktivitetet e partnerëve të Korpusit të Paqes

*Ne mendojmë se atë që e bëjmë është vetëm një pikë uji në oqean. Por oqeani do të ishte më i vogël pa atë pikë. – Nënë Tereza*



## PROJEKTE

### ZHVILLIMI I KOMUNITETIT

Projektet për zhvillimin e komunitetit, të fokusuar në zhvillimin e të rinjve, i mbështesin komunitetet dhe organizatat që në mënyrë efektive të menaxhojnë zhvillimin e komunitetit. Ne punojmë së afërmi me organizata të sektorit civil, komunat dhe institucionet tjera publike nëpër tërë Maqedoninë. Prioritet për vullnetarët dhe bashkëpunëtorët e tyre lokal janë këto aktivitete:

- Përmirësimi në planifikim, qëndrueshmëria financiare, menaxhimi i brendshëm dhe ndërtimi i kapacitetit të stafit për dizajnim të projekteve, menaxhim dhe dhënie të shërbimeve;
- Mbështetja e organizatave gjatë gjetjes së nevojave të komunitetit dhe ndërtimi i partneritetit strategjik për t'ju përgjigjur nevojave të njejta;
- Trajnimi i njerëzve për pjesëmarrje aktive në komunitet, aftësim për jetë dhe rritjen e vetëdijes për personat me nevoja të veçanta;
- Bashkërisht organizojnë dhe udhëheqin klube, orë dhe kampe për leadership dhe zhvillim të të rinjve.

### MËSIMDHËNIE TË GJUHËS ANGLEZE

Vullnetarët punojnë në shkolla fillore dhe të mesme nëpër tërë shtetin që nga viti 1996, me fokus të theksuar në vendet rurale dhe të marginalizuara. Gjatë punës, vullnetarët përparësi iu japin këtyre gjërave:

- Përmirësimin e orëve të gjuhës angleze me metoda të cilat e vendosin nxënësin në fokus të orës;
- Rritjen e suksesit të nxënësve gjatë mëimit të gjuhës angleze;
- T'ju ndihmojnë arsimtarëve të gjuhës angleze rreth nxënësve me nevoja të veçanta gjatë orës së mëimit;
- T'ju ofrojnë arsimtarëve trajnim të vazhdueshëm;
- Organizimi i klubeve të gjuhës angleze dhe aktiviteteve jashtë mëimit si gara në drejtshkrim, sport, Model UN, etj.

### NEVOJA TË VEÇANTA

Vullnetarët e Korpusit të Paqes të cilët kanë përvojë, aftësi dhe shkollimin e duhur për punë me persona me nevoja të veçanta punojnë në organizata për këto qëllime:

- Për të punuar me edukatorët për krijimin dhe implementimin e aktiviteteve ditore, materialeve dhe metodave të reja;
- Për të punuar me individ dhe me prindërit e tyre për të mbështetur zhvillimin e aftësive profesionale;
- Për të trajnuar të rinj nga bashkësia që të mund të kryejnë punë vullnetare dhe të punojnë me persona me nevoja të veçanta;
- Mbajtjen e puntorive për zhvillim të aftësiv për jetë.